



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



KUVENDI KOMUNAL

01- Nr 15-29

Me datë 31.07.2024

Në bazë të nenit 53 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 8 dhe 9 paragrafi 1 pika 2 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve të Tjera në Komunë, nenit 65 dhe 67 të Statutit të Komunës së Mamushës e datës 01.12. 2008,

V E N D I M

Zgjedhja e Anëtarit të ri të Komitetit për Komunitete

I

z. Halim Sadiku Anëtar i Kuvendit Komunal në Komunën e Mamushës nga subjekti politik PDK zgjedhet anëtar i ri Komitetit për Komunitete në Komunën e Mamushës

II

Bazuar në Ligjin për vetëqeverisje lokale nr.03/l-040, udhëzimit administrativ (MPL) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve të tjera në komunë, Komiteti për Komunitete përfshinë radhët e veta me shumicë e thjesht nga anëtarët e Kuvendit Komunal.

III

Çdo Komunitet që jeton në Komunë përfaqësohet nga së paku një përfaqësues në Komunitetin për Komunitete.

IV

Komiteti për Komunitete është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve Komunale me Ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave Komunale, praktikave dhe aktiviteteve për tu siguruar se të drejtat dhe interesat e Komuniteteve respektohen në plotësisht.

V

Për ekzekutimin e këtij vendimi kujdeset, Kryesuesi i Kuvendit dhe Zyra e Personelit në Komunën e Mamushës.

A r s y e t i m

znj. Albijona Sadiku Kryesuese e Komitetit për Komunitete në Komunën e Mamushës me datë 23.05.2024 ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë për arsye të migrimit jashtë shtetit , andaj në bazë të Udhëzimi Administrativ (MAPL) nr. 05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve Tjera në Komunë andaj në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika 2.2 në bazë të dorëheqjes me nr të protokollit 02-38-24 të datës 23.05.2024

bëhet zgjedhja e anëtarit të ri dhe rrjedhimisht Kuvendi Komunal pas propozimit të Komunitetit shqiptar bazuar në nenin 8 pargarfi 2 të udhëzimit administrativ (mpl) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve, si anëtar të ri të Komiteti për Komunitete ka Poropozuar z. Halim Sadikun anëtar nga Komuniteti shqiptar që të jetë anëtar i Komitetit..

Të njoftohen :
Zyra e Kryetarit
Zyra e Personelit
Arkivi

Kryesues i Kuvendit Komunal në Maqarashë


Nedmedin Gorrina

